



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**UDHËZIM**

**Nr. 3 datë 19. 06. 2012**

**“PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 241 DATË  
21.11.2005 “PËR REGJISTRIMIN E NJOFTIMIT TË VEPRËS PENALE DHE TË  
EMRIT TË PERSONIT QË I ATRIBUOHET VEPRRA PENALE”, (I  
NDRYSHUAR)”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 paragrafi “gj” të ligjit nr.8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar),

**U D H Ë Z O J:**

Në udhëzimin nr.241 datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, (i ndryshuar), bëhen një shtesë dhe një ndryshim si më poshtë:

1. “Në pikën 2.2 shprehja “deri në 20 ditë” zëvendësohet me shprehjen “deri në 30 ditë”.
2. Pas pikës 2.2, shtohet pika 2.3 me këtë përmbajtje:

“2.3 Gjatë periudhës 30 ditore, të parashikuar në pikën 2.2 të këtij Udhëzimi, prokurori, kryen vetëm verifikime në lidhje me rrethanat që lejojnë ose nuk lejojnë fillimin e procedimit penal. Gjatë kësaj periudhe, prokurori, nuk kryen veprime hetimore nga ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.””.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**INA RAMA**



ERROR: syntaxerror  
OFFENDING COMMAND: --nostringval--

STACK:

/Title  
( )  
/Subject  
(D:20120619143403+02'00')  
/ModDate  
( )  
/Keywords  
(PDFCreator Version 0.9.5)  
/Creator  
(D:20120619143403+02'00')  
/CreationDate  
(ekanina)  
/Author  
-mark-